Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar I Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/496
Datë: 27.11.2020

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 28.10.2020 nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Akreditohet Shoqata "Getting Competent" (Get-Com), me adresë Rr. "Zahir Pajaziti", nr. 20,10000 në Prishtinë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 28.10.2020 deri 28.10.2023, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **Instruktor në vendin e punës,** Niveli IV sipas KKK me 4 kredi të AAP. Numri i kandidatëve për grup në këtë institucion dhe për këtë kualifikim është maksimumi 18 kandidatë.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Shoqatës "Getting Competent" për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi rivalidimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve për Riakreditim të institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për Riakreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente të tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur, dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit,sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Shoqatës "Getting Competent" (Get-Com);
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetari i KD së AKK